



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2023:190070

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05994598

C.A.P.nr.1652/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit XH, F, R, dhe A të gjitha nga fshati G....., Komuna e S....., të cilët më autorizim i përfaqëson M.Q, avokat nga P...., kundër debitorit Ndërmarrja N.SH.T. “Malik Impex”, me seli në Komunën e P....., Rruga “Jusuf Gërvalla”, p.nr., lidhur me çështjen përmbartimore, për kërkesën në të holla, në shumën 5,418.00 euro, në emër të kompensimit, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.95/223 i datës 27.10.2023, me datë 29.07.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit Ndërmarrja N.SH.T. “Malik Impex”, me seli në Komunën e Prizrenit, Rruga “Jusuf Gërvalla”, p.nr., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.95/23 i datës 27.10.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.95/23 i datës 27.10.2023, ka vendosur si në vijim: “REFUZOHET si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përmbartimit Ndërmarrja N.SH.T. “Malik Impex”, me seli në Komunën e Prizrenit, Rruga “Jusuf Gërvalla” i ushtruar kundër urdhërit mbi caktimin e përmbartimit P.nr.262/23 i datës 09.08.2023, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat, mbetet në fuqi urdhri mbi caktimin e përmbartimit P.nr. P.nr.262/23 i datës 09.08.2023 i Organit Përmbartues – Përmbartuesit Privat E.H, në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar bashkë me prapësimin e debitorit dhe t’a prish Urdhrin për Përmbartim dhe ta pezulloi detyrimin e debitorit ndaj kreditorit, për shkak se nuk është vërtetuar se debitori i ka borxh kreditorit.

Përgjigje në ankesë nuk kanë parashtruar kreditorët.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se :

-Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorët me datën 09.08.2023, kanë paraqitur propozim të Organit Përmbartues, në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë C.nr.406/2019 të datës 10.03.2023, i plotfuqishëm nga data 19.07.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 09.08.2023.

Përmbartuesi Privat E.H në P....., me Urdhrin Përmbartimor, P.nr.262/23 të datës 09.08.2023, e ka lejuar përmbartimin.

Pas pranimit të urdhrit për përmbartim, debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësim pranë Gjykatës së shkallës së parë, me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.95/23 i datës 27.10.2023, e ka refuzuar prapësimin duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka theksuar përmbartimi është lejuar me urdhrin përmbartimor të Përmbartuesit Privat E.H në Prizren, me Urdhrin Përmbartimor, P.nr.262/23 të datës 09.08.2023. Gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimet prapësuese të debitorit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për arsye se debitori në prapësim nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç parashihet në nenin 69 par.4 të LPP-së, në të cilin nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit apo shtyrjen e tij. Gjykata ka vërtetuar se dokumenti përmbartues si Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë C.nr.406/2019 të datës 10.03.2023, i plotfuqishëm nga data 19.07.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 09.08.2023. I cili dokument i plotëson kushtet ligjore dhe shërben si bazë juridike dhe titull ekzekutiv i përmbartueshëm dhe

i përshtatshëm për përmbarrim, në të cilin janë treguar kreditori, debitori, objektet, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, ashtu siç kërkohet në nenin 36 par.1 të LPP-së. Gjykata e Apelit, vendimin e gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet e mësipërme ankimore gjen se të njëjtat nuk qëndrojnë për faktin se në këtë çështje juridike përmbarrimore kemi të bëjmë me ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, në bazë të t' cilit edhe është bërë propozimi për përmbarrim dhe që i përmbush të gjitha elementet për tu konsideruar si titull ekzekutiv e në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë vlerëson se urdhri për përmbarrim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së dhe atë për faktin se propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të dokumentit të përmbarrues –vendimi i Gjykatës i përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par 1.2 të këtij ligji i cili përcakton se: *“1. Dokumente përmbarruese janë: 1.1. vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese;*, po ashtu Ligji për procedurën përmbarrimore e përcakton edhe çka konsiderohet vendim i Gjykatës ku neni 23 par.1 përcakton se: *“1. Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”*, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara kjo Gjykatë vlerëson se urdhri për përmbarrim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me këto dispozita, andaj nuk ekziston asnjë shkak që kjo Gjykatë të mos e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se propozimi për përmbarrim është bërë në përputhje edhe me nenin 36 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri.”* Vendimi i Gjykatës në bazë të t'cilit është bërë propozimi për përmbarrim është bashkëngjitur në kopje të vërtetuar dhe se i njëjti e

përmban vulën plotfuqishmërisë, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 19.07.2023, ndërsa i ekzekutueshëm me datë 09.08.2023.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsyeje të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pa bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
C.A.P.nr.1652/2023 me datë 29.07.2024

Gjyqtari,  
Adnan Konushevci d.v